

VENDIM
Nr. 86, datë 20.4.2018

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SEMAN SUNPOWER” SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK TOPOJË (SHEQ, MARINAS), ME FUQI TË INSTALUAR 2000 kw

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 4, pika 1, germa “a”; të nenit 5, pika 1, germa “a”; të nenit 13 dhe 14, pika 2 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016”; të nenit 15 të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.4.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi licencimin e shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë (Sheq, Marinas), me fuqi të instaluar 2000 kw,

konstatoi se:

- Me shkresën me nr. 109 prot., datë 26.1.2018, shoqëria “Seman Sunpower” sh.p.k. ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë.

- Në datën 29.12.2017 është lidhur kontrata me nr. 6299 rep. dhe 1598 kol., “Për ndërtimin shfrytëzimin dhe administrimin e Centralit Fotovoltaik Topojë, me kapacitet të instaluar 2000 kw; në zonën Sheq, Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier, midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe mbajtësit të miratimit përfundimtar, shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me miratimin përfundimtar nr. 4115/3 prot., datë 28.12.2017, ka miratuar ndërtimin e Centralit Fotovoltaik Topojë në favor të “Seman Sunpower” sh.p.k., me fuqi të instaluar 2000 kw, në koordinatat e përcaktuara në nenin 3 të kontratës së sipërcituar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 33, datë 7.2.2018, filloi procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë (Sheq, Marinas), me fuqi të instaluar 2000 kw.

- Me shkresën me nr. 55/3 prot., datë 9.2.2018, është bërë njoftimi për median, lidhur me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me vendndodhje në zonën Sheq, Marinas, Qarku Fier.

- Pas përfundimit të afatit për paraqitjen e vërejtjeve ose të ankesave, nuk rezulton të jetë paraqitur në ERE asnjë ankesë ose vërejtje nga subjekte ose persona fizikë në lidhje me këtë aplikim.

- Pas vendimmarrjes së bordit, ERE-s, me shkresën nr. 109/2 prot., datë 23.2.2018, i është drejtuar subjektit “Seman Sunpower” sh.p.k., për plotësimin e dokumentacionit të munguar brenda 20 ditëve kalendarike.

- Subjekti “Seman Sunpower” sh.p.k., me shkresën nr. 86 prot., datë 12.3.2018, protokolluar në ERE me nr. 110/4 prot., datë 12.3.2018, si dhe shkresën datë 27.3.2018, protokolluar në ERE me nr. 110/7 prot., datë 28.3.2018, ka depozituar në ERE dokumentacionin plotësues.

- Aplikuesi në referencë të “Rregullores për procedurat afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, përkatësisht neni 9, pika 4.4.4, germa “c”, ka depozituar në ERE shkresën me nr. 89 prot., datë 17.4.2018, “Oponenca teknike e projektit”.

- Aplikimi i shoqërisë “Seman Sunpower” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e

licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germet “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germet “a” dhe “d”, “b”, “c”, “e”, “f”, “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germet “a”, “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.4.1, 4.4.2, 4.4.3 (germet “a”, “b”, “c”, “d”), 4.4.5, germa “a” është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Seman Sunpower” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë (Sheq, Marinas), me fuqi të instaluar 2000 kw për një afat 20-vjeçar (njëzetvjeçar).

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti